



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.04.2013

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2013, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 16., të datës 26.03.2013, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 18, shkronja (b), nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), shkresës së Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr. 03/022, të datës 14.03.2013, nenin 12, pika 12.2, shkronja (b), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për lirimin nga taksa komunale për regjistrim në Zyrën e Gjendjes Civile, të paraparë me Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, Nr. 01, të datës 13.01.2010, për qytetarët e komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptian, për periudhën njëvjeçare, për:
 - Regjistrimin e rregullt të lindjes në LAL,
 - Regjistrimin e mëvonshëm të lindjes në LAL,
 - Regjistrimin e rregullt të vdekjes në LAV dhe
 - Regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes në LAV.
- II. Obligohet, Drejtoria për Administratë - Zyra e Gjendjes Civile që të bëjë regjistrimin falas në përputhje me pikën 1 të vendimit dhe të pajis qytetarët e komunitetit rom ashkalinj dhe egjiptian me certifikata pas përfundimit të procedurës së regjistrimit.
- III. Është në kompetencë të Drejtorisë për Administratë dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim të njoftojnë qytetarët e këtyre komuniteteve për mundësimin e regjistrimit falas në Zyrën e Gjendjes Civile, kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për regjistrim në Regjistrin Civil dhe për lëshimin e certifikatave palëve me rastin e regjistrimit.
- IV. Për çdo kërkesë tjetër për marrjen e certifikatave pas regjistrimit, qytetari është i obliguar të paguaj taksat sipas Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, Nr. 01, të datës 13.01.2010.
- V. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe vlen së zbatuari duke filluar nga data 03.04.2013 e deri më 03.04.2014.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për Administratë, ZKKK dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavaj